

A do të më duhet të paraqes ndonjë dokument?

Mund t'ju kërkohet të paraqisni dokumente në varësi të rastit për të cilin kualifikoheni. Përgatituni të paraqisni një dokument për secilën kategori si më poshtë. Nëse aplikoni në person, sillini me vete. Nëse aplikoni me telefon, do t'ju kërkohet t'i ngarkoni ato në MyChart ose t'i siguronit gjatë takimit tuaj. Nëse nuk keni dokumente të caktuara, mos u shqetësoni! Mund t'ju ndihmojmë gjithsesi.

Shembuj të dokumenteve të pranuara Dëshmi identiteti

Karta e Përhershme e Banimit në SHBA (Green Card), Leje e Punës në SHBA, Natyralizimi, Libri ose Karta e Pasaportës Amerikane, Patentë Shoferi, ID e Jo-Shoferit DMV, IDNYC, Certifikata e Natyralizimit në SHBA, Certifikata e Shtetësisë në SHBA, Karta EBT/CBIC e NYS, ID e shkollës, Certifikata e martesës, Certifikata e lindjes

Dëshmia e rezidencës

Letër Marrëveshja e Rezidencës, Marrëveshja e Qirasë (jo e skaduar), Faturë e Qirasë (90 ditët e fundit), Deklarata e hipotekës ose evidenca e tatimit në pronë, Fatura e shërbimeve/deklarata bankare (90 ditët e fundit), Zarfi me vulë postare (90 ditët e fundit), Fatura e hotelit/motelit, Fatura e spitalit, Vetëdeklarimi i vendbanimit

Vërtetimi i të ardhurave familjare

Mandat pagese, Letër e Punës, Letër e Çmimeve të Pensionit, Letër e të Ardhurave

të Asistencës Publike, Letër e Mbështetjes/ Ndhmës Financiare për Fëmijët, Letër e shpërblimit për papunësi, Letër e Çmimit të Sigurimeve Shoqërore, Letër e shpërblimit SSI/SSD, Letër e shpërblimit të punëtorit, Deklarata më e fundit W2/Deklarimi tatimor, Letër mbështetëse ose Vetëdeklarim i të ardhurave

Vendimi i së drejtës për përfitim sigurimi

Nëse jeni shqyrtuar tashmë lidhur me kualifikimin për sigurimin nga një Asistor nga një organizatë tjetër ose vetë përmes New York State of Health Marketplace (30 ditët e fundit)

Po në rast se marr një faturë ndërkohë që jam në pritje të një përgjigjeje lidhur me mbulimin tim me sigurim shëndetësor?

Nëse keni aplikuar për sigurime shëndetësore, nuk do t'ju kërkohet të paguani faturën gjatë kohës që aplikimi juaj është duke u shqyrtuar. Nëse merrni një faturë, duhet të na kontaktoni dhe të kërkonit të flisni me këshilluesin financiar i cili do t'ju vijë në ndihmë.


Si të aplikoj?

Konsulentët tanë financiarë mund të ndihmojnë, ju aplikoni për mbulim të sigurimit shëndetësor ose ndihmë financiare. Telefononi 1-844-692-4692 dhe zgjidhni opsionin 3 për të folur me një konsulent financiar.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Ndihma financiare e NYC Health + Hospitals



Vizitoni nyccare.nyc për informacion lidhur me mënyra të tjera për të aplikuar.

NYC Health + Hospitals ofron kujdes shëndetësor për të gjithë. Ne respektojmë të drejtat dhe privatësinë e të gjithë pacientëve, duke përfshirë edhe personat pa dokumente. Ne ndihmojmë edhe personat që nuk flasin anglisht të komunikojnë me mjekët dhe anëtarët e tjerë të personelit. Personeli ynë flet shumë gjuhë, duke përfshirë gjuhën shqipe, arabe, bengale, kineze, frënge, kreole haitiane, hindi, koreane, polake, ruse, spanjolle dhe urdu. Ofrohen edhe shërbime interpretimi. Ju mund të merrni informacion në gjuhën tuaj.

Për më shumë informacion
dhe për regjistrim telefononi

1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

nyccare.nyc



QËNDRONI TË INFORMUAR. NA NDIQNI.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Nuk keni sigurim shëndetësor?
Mos u shqetësoni, ne mund t'ju ndihmojmë.

Ju keni të drejtën për kujdes shëndetësor të përballueshëm dhe të cilësisë së lartë. Mënyra më e mirë për t'u siguruar që kujdesi të jetë i përballueshëm është të regjistroheni në sigurimin shëndetësor. Ne mund t'ju ndihmojmë duke ju shpjeguar zgjedhjet e disponueshme për ju dhe t'ju asistojmë gjatë regjistrimit në planin më të përshtatshëm për ju dhe familjen tuaj. Nëse nuk kualifikoheni ose nuk mund të përballoni ndonjë nga planet e disponueshme të sigurimit shëndetësor falas ose me kosto të ulët, mund të kualifikoheni për një nga programet tona të ndihmës financiare - **NYC Care** ose **Options** – për t'i bërë shërbimet tona të kujdesit shëndetësor të përballueshëm për ju dhe familjen tuaj.

Si mund të informohem lidhur me zgjedhjet që ofrohen?

Flisni me një këshillues financiar të NYC Health + Hospitals që mund t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj të regjistroheni në një plan sigurimesh shëndetësore falas ose me kosto të ulët, në rast se i plotësoni kushtet. Këshilluesit tanë financiarë janë këtu për t'ju ndihmuar të zgjidhni nga një shumëllojshmëri planesh për sigurime shëndetësore, për të cilat ju mund t'i plotësoni kushtet. Nëse nuk i plotësoni kushtet për asnjë plan sigurimesh shëndetësore, nuk përballoni dot mbulimin me sigurim, apo nuk keni para për të paguar për kujdesin mjekësor, ju mund të kualifikoheni për një programet tona të ndihmës financiare.

NYC Care është në dispozicion për njerëzit që nuk kualifikohen për ose nuk mund të përballojnë sigurimin shëndetësor dhe jetojnë në qytetin e New York.

Options është i disponueshëm për njerëzit që nuk kualifikohen ose nuk mund të përballojnë sigurimin shëndetësor dhe jetojnë ose vizitojnë qytetin e New York ose qarqet Nassau ose Westchester.

Pse është i rëndësishëm sigurimi shëndetësor?

Askujt nuk i pëlqen të lëndohet ose të sëmuret, por ngjarje të paparashikuara mjekësore mund të ndodhin. Një plan

sigurimesh shëndetësore ju ndihmon të paguani disa nga këto kosto të paparashikuara, duke përfshirë faturat mjekësore të vazhdueshme me vlera të mëdha dhe barnat me recetë, dhe mund t'ju ofrojë siguri. Ne dimë gjithashtu se personat me sigurime shëndetësore kanë më shumë gjasa të marrin kujdesin parandalues që ju duhet atyre dhe familjes së tyre për të qëndruar të shëndetshëm.

Sa do të paguaj?

Ofrohen shumë plane sigurimesh shëndetësore falas ose me kosto të ulët. Ne mund t'i diskutojmë këto zgjedhje me ju. Nëse nuk kualifikoheni për sigurim shëndetësor dhe kualifikoheni për ndihmë financiare, do të paguani një tarifë të përballueshme. Grafiku në faqen vijuese tregon se sa mund t'ju kërkohet të paguani me një nga programet tona të ndihmës financiare. Tarifa që ju duhet të paguani për një vizitë te mjeku mund të jetë edhe \$0.

Çfarë më nevojitet për të aplikuar?

Do t'ju kërkohet të jepni informacion për veten, familjen dhe të ardhurat e familjes. Ne do t'ju ndihmojmë të zgjidhni nga një shumëllojshmëri planesh sigurimi shëndetësor dhe programesh të ndihmës financiare për të cilat ju mund t'i plotësoni kushtet. Ky aplikim është i sigurt dhe asnjë informacion nuk ndahet me nëpunësit e emigracionit.

Vazhdon

Hapi 1:

Gjeni madhësinë e familjes suaj (ju lutemi përfshini të gjithë të rriturit dhe fëmijët që jetojnë me ju).

Hapi 2:

Më pas, gjeni pagën tuaj vjetore në një nga nivelet.

Hapi 3:

Ndiqui kolonën deri në grafikun e fundit për të zbuluar se sa do t'ju kërkohet të paguani, sipas numrit të personave në familjen tuaj dhe të ardhurave tuaja familjare, për vizitat në klinikë, vizitat në urgjencë dhe shtrimet në spital.

Nivelet federale për varfërinë (FPL)	200% FPL	201 - 250% FPL		251 - 300% FPL		301 - 350% FPL		351 - 400% FLP		401 - 500% FLP	
Madhësia e familjes	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se
1	31,300	31,301	39,125	39,126	46,950	46,951	54,775	54,776	62,600	62,601	78,250
2	42,300	42,301	52,875	52,876	63,450	63,451	74,025	74,026	84,600	84,601	105,750
3	53,300	53,301	66,625	66,626	79,950	79,951	93,275	93,276	106,600	106,601	133,250
4	64,300	64,301	80,375	80,376	96,450	96,451	112,525	112,526	128,600	128,601	160,750
5	75,300	75,301	94,125	94,126	112,950	112,951	131,775	131,776	150,600	150,601	188,250
6	86,300	86,301	107,875	107,876	129,450	129,451	151,025	151,026	172,600	172,601	215,750
7	97,300	97,301	121,625	121,626	145,950	145,951	170,275	170,276	194,600	194,601	243,250

Vizitë në Klinikë Mjekësore	\$0	\$20	\$20	\$30	\$40	\$50
Vizita në klinikë për shëndetin biheviorial	\$0	\$15	\$20	\$30	\$40	\$50
Vizita vetëm për vaksinë	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0
Vizitë në dhomën e urgjencës	\$0	\$30	\$30	\$60	\$60	\$100
Mjekime me recetë (për recetë)	\$0	\$3	\$3	\$6	\$6	\$20
Kirurgjia Ambulatore	\$0	\$200	\$200	\$450	\$450	\$650
Skanimi i Rezonancës Magnetike (MRI)	\$0	\$50	\$50	\$100	\$100	\$150
Tomografi me Emetim të Pozitroneve (PET)	\$0	\$150	\$150	\$300	\$300	\$500
Qëndrimi në spital	\$0	\$150	\$400	\$900	\$1200	\$1500
Bashkëpagesat, bashkë-sigurimet dhe zbritjet	\$0	10% e pjesës së kostos		20% e pjesës së kostos		30% e pjesës së kostos

Tarifat për pacientët me të ardhura familjare më të larta se vlerat e mësipërme do të faturohen mbi bazën e normës së Vetëpagesës të NYC Health + Hospitals.